

VENDIM
Nr.335, datë 2.3.2011

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1720, DATË 29.10.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRITERET E PËRCAKTIMIT TË NIVELI TË LARTË SPORTIV,
PËR MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË SPORTISTËVE QË I ARRIJNË KËTO NIVELE,
SI DHE PËR PËRFITIMIN E TRAJTIMIT PËR PËRGATITJEN SPORTIVE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 6 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1720, datë 29.10.2008 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

- a) Shkronjat “ç” dhe “d”, të nënndarjes 1.1 të pikës 1, ndryshohen, si më poshtë vijon:
“ç) Vendi i parë deri në vendin e gjashtë, në Lojërat Olimpike;
d) Vendi i parë deri në vendin e pestë, në kampionate botërore.”.
- b) Tabela 1 bashkëlidhur vendimit zëvendësohet me tabelën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha